إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، اَللَّهُمَّ بَـــارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ، إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ"

"Allahum-me sali ala Muhamedin ue ala ali Muhamedin kema salejte ala Ibrahime ue ala ali Ibrahime in-neke Hamidun Mexhid. Allahum-me barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamedin kema barekte ala Ibrahime ue ala ali Ibrahime in-neke Hamidun Mexhid"

"O Allah! Mëshiroje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij! Me të vërtetë Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar. O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij! Me të vërtetë Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar".

Më pas i kërkon mbrojtje Allahut nga katër gjëra:

"اَللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَى وَالْمَمَاتِ، وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ"

"Allahum-me in-ni eudhu bike min adhabil kabri, ue min adhabi xhehen-nem, ue min fitneti mehja ue memat, ue min fitnetil mesihi dexh-xhal"

"O Allah! Kërkoj mbrojtje prej Teje nga dënimi i varrit, nga dënimi i Xhehenemit, nga të këqiat që vijnë gjatë jetës e vdekjes dhe nga sprova e Dexhalit".

Në këtë pozicion mund të bësh edhe lutje të tjera derisa të japësh selam, si p.sh:

"اَللَّهُمَّ أَعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ"

"Allahum-me eini ala dhikrike ue shukrike ue husni ibadetike"

"O Allah! Më ndihmo të përkujtoj, të falenderoj e të adhuroj ashtu siç duhet".

(12) Jep selam fillimisht nga e djathta, pastaj nga e majta duke thënë:

"اَلسَّلاَمُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ الله"

"Es-selamu alejkum ue rrahmetullah"

"Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ju".

(13) Nëse namazi është me tre rekate si akshami, apo me katër rekate si dreka, ikindia dhe jacia, pasi mbaron thënien e teshehudit ngrihesh për në rekatin e tretë duke u mbështetur tek gjunjët, nëse ke mundësi (e kundërta e fotos nr: 3), duke thënë: "اَللَّهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**

(14) Lexon në të vetëm suren fatiha, pastaj plotëson namazin ashtu sikurse e kemi shpjeguar më lartë. Bën teshehudin në fund të rekatit të tretë nëse fal akshamin dhe në fund të rekatit të katërt nëse fal drekën, ikindinë dhe jacinë, pastaj jep selam.

Veprimet e mësipërme, veproi me renditje dhe i qetë (pa u nxituar).

(15) Kërkohet nga besimtari që t'i fali namazet me xhemat në xhami dhe të mos e anashkaloj diçka të tillë, në mënyrë që të jetë prej të shpëtuarve.

(16) Është mirë që muslimani të kujdeset edhe për faljen e dymbëdhjetë rekateve synete (përveçse kur është udhëtar) të cilat janë: dy rekate para sabahut, katër rekate para drekës dhe dy pas saj, dy rekate pas akshamit dhe dy rekate pas jacisë. Profeti alejhi selam për vlerën e tyre ka thënë: ***"Kush fal dymbëdhjetë rekate gjatë ditës dhe natës, do t'i ndërtohet një shtëpi në Xhenet".*** (Transmeton Muslimi: 728) Ndërsa kur je udhëtar, fal vetëm synetet e sabahut dhe namazin e vitrit.

(17) Disa gabime në namaz:

1- Kryerja e veprimeve përpara imamit

2- Ngritja e syve në qiell gjatë namazit



FORMA E NAMAZIT TË XHENAZES

(1) Merr tekbirin fillestar duke patur nijet namazin e xhenazes (i ngren duart si në foton nr: 1), pastaj thua:

"اَللَّهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**



Vendos dorën e djathtë mbi të majtën, pastaj lexon suren fatiha.

(2) Merr tekbir duke thënë: "اَللَّهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**, pastaj bie në salevat për Profetin alejhi selam.

(3) Merr tekbir për herë të tretë duke

thënë: "اَللَّهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**

e pastaj i lutesh Allahut për të vdekurin me duanë e mëposhtme:

"اَللَّهُمَّ اغْفِرْ لِحَيِّنَا وَمَيِّتِنَا وَشَاهِدِنَا وَغَائِبِنَا وَصَغِيرِنَا وَكَبِيرِنَـــا وَذَكَرِنَا وَأُنْثَانَا، اللَّهُمَّ مَنْ أَحْيَيْتَهُ مِنَّا فَأَحْيِهِ عَلَى الْإِسْلَامِ وَمَنْ تَوَفَّيْتَهُ مِنَّا فَتَوَفَّهُ عَلَى الْإِيمَانِ"

"Allahum-me g'fir lihaj-jina ue mej-jitina ue shahidina ue gaibina, ue sagirina ue kebirina. Allahum-me men ahjejtehu min-na fe ahjihi alel islam, ue men teuefejtehu min-na fe teuefehu alel iman"

"O Allah! Mëshiroji të gjallët e të vdekurit tanë, ata që janë këtu me ne dhe ata që mungojnë, të vegjlit e të mëdhenjtë, meshkujt dhe femrat. O Allah! Atë që lejon të jetojë nga ne, jepi mundësi të jetojë si musliman i mirë, atë që e largon nga kjo botë largoje si besimtar!"

(4) Merr tekbir për herë të katërt duke thënë: "اَللَّهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**

pastaj jep selam nga krahu i djathtë duke thënë: "اَلسَّلاَمُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ الله"

"Es-selamu alejkum ue rrahmetullah".

Profeti alejhi selam ka thënë: ***"Kush prezanton në një xhenaze derisa të falet ka shpërblim një "kirat" e nëse prezanton derisa të varroset ka dy "kirate""*** I është thënë se çfarë janë dy "kirate"? Ai ka thënë: ***"Sa dy male të mëdhenj".*** (Transmeton Buhari: 1325 dhe Muslimi: 945)

Gjithashtu ka thënë: ***"Shpejtoni xhenazen se nëse është i mirë atëherë është hajr për të, e nëse është i keq atëherë ju hiqni një të keqe prej supeve tuaja".*** (Transmeton Buhari: 1315 dhe Muslimi: 944)

رقم سجل لدى الادارة العامة للبحوث، والتأليف، والترجمة بالأزهر الشريف (17898)

بسم الله الرحمن الرحيم

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَوْقُوتًا﴾ النساء- 103

"Vërtet falja (namazi) u është bërë obligim besimtarëve në kohë të përcaktuar"

Profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te!), ka thënë:

- ***"Kush kujdeset për namazin, do të jetë për të dritë, argument dhe shpëtim ditën e Gjykimit"*** (Transmeton Ahmedi: 6540 dhe Darimi: 2721)
- ***"Midis njeriut, mosbesimit dhe shirkut është namazi"*** (Muslimi: 82)
- ***"Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur"*** (Transmeton Buhari: 631)

MËNYRA E SHKURTUAR E FALJES SË PROFETIT, ﷺ



صفة صلاة النبي ﷺ
-باختصار-



باللغة الألبانية

بلغات العالم *50 لغة*
غازي بن علي سلطان الداغستاني
المتخرج من الجامعة الإسلامية بالمدينة المنورة
المدينة المنورة +966504352709
1432/2011 +201115587559

(1) Kur të falesh duhet të jesh i pastërt dhe me abdes, të drejtohesh nga kibla (Kabja) prej fillimit të namazit e deri në përfundim të tij, duke patur për qëllim (nijet) në zemër namazin që do të falësh.

(2) Merr tekbirin fillestar (shikimin tënd e përqendron në vendin e sexhdes dhe duart i ngren si në foton nr: 1) duke thënë:



"اَللهُ أَكْبَرُ"

"Allahu Ekber"

Allahu është më i Madhi".

(3) Gjatë qendrimit në këmbë dorën e djathtë e vendos mbi të majtën dhe lexon lutjen e hapjes:

"سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، وَتَبَارَكَ اسْمُكَ، وَتَعَالَى جَدُّكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ"

"Subhaneke Allahum-me ue bihamdike ue tebareke s'muke ue teala xhed-duke ue la ilahe gajruke"

"Lavdia të përket ty o Allah! Falenderimet të përkasin vetëm Ty! Emrat e tu janë të bekuar. Madhëria jote është e paarritshme! Askush tjetër nuk meriton të adhurohet veç Teje".

Pastaj thua:

"أَعُوذُ بِاللهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ"

"Eudhu bil-lahi mine shejtani rraxhim"

"I kërkoj mbrojtje Allahut nga shejtani i mallkuar".

Më pas lexon suren ***"Fatiha"***:

﴿بِسْمِ اللهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ(١) الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ(٢) الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ(٣) مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ(٤) إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ(٥) اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ(٦) صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ(٧)﴾ "آمين"

﴾(1)Bismil-lahi Rrahmani Rrahim. (2)Elhamdu lil-lahi Rab-bil alemin. (3)Err-rrahmani Rrahim. (4)Maliki jeumi din. (5)Ij-jake nabudu ue ij-jake nestein. (6)Ihdina siratal mustekim. (7)Siratal-ledhine en'amte alejhim gajril magdubi alejhim ue led-dál-lin.﴿ "Amin"


﴾1.Me emrin e Allahut Mëshiruesit Mëshirbërësit. 2.Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! 3.I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. 4.Zotëruesi i Ditës së Gjykimit. 5.Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të mbështetemi e të kërkojmë ndihmë. 6.Drejtona në Rrugën e Drejtë. Në Rrugën e atyre të cilëve Ti u ke dhuruar Mëshirën Tënde. 7.Jo në (rrugë) të atyre që e merituan Zemërimin Tënd mbi vete dhe as në (rrugë) të atyre të cilët e humbën veten.﴿ *"Amin"*

Pasi mbaron fatihan lexon ç'të mundesh prej Kur'anit.

(4) Shkon në ruku (përkulesh), duke thënë:

"اَللهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**

(Kërkohet që gjatë rukusë, kokën ta mbash drejt me shpinën dhe duart ti vendosësh mbi gjunjë duke i hapur gishtrinjtë nga njëri-tjetri si në foton nr: 2), pastaj thua tre herë:



"سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ"

"Subhane Rab-bijel Adhim"

"I Lavdishëm është Zoti im i Madhëruar".

(5) Ngrihesh nga rukuja duke thënë:

"سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ"

"Semiallahu limen hamideh"

"Allahu i përgjigjet atij që e falenderon Atë".

Pasi ngrihesh plotësisht thua:

"رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ، حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ"

"Rab-bena ue lekel hamd, hamden kethiren taj-jiben mubareken fihi"


"O Zoti ynë! Ty të përket falenderimi i pakufizueshëm, begatia dhe mirësia janë vetëm prej Teje".


(6) Bie në sexhde duke thënë:

"اَللهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**



Në sexhde fillimisht bie me gjunjë, pastaj vendos duart nëse është e mundur (si në foton nr: 3.1-3.4) Gishtërinjtë e këmbëve dhe të duarve i drejton nga kibla duke i mbajtur të bashkuar. Duart i vendos në drejtim me supet dhe krahët i hap, duke mos i bashkuar me brinjët, po ashtu kofshët nuk i bashkon me barkun dhe qafën nuk e mbanë të mbledhur. Sexhdja kryhet me këto gjymtyrë: ballin, hundën, duart, gjunjët dhe gishtërinjtë e këmbëve (si në foton nr: 4.1-4.4),





më pas thua tre herë:

"سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى" **"Subhane Rab-bijel Ala"**

"I Lavdishëm është Zoti im, i Lartësuar".

(Lejohet ti lutesh Allahut me çdo lutje në të gjitha sexhdet, e nëse nuk di arabisht, lutu në shqip)

(7) Ngrihesh nga sexhdja duke thënë:

"اَللهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**

Më pas ulesh (duke shtrirë këmbën e majtë, pastaj ulesh mbi të, këmbën e djathtë e mban drejt dhe duart i vendos mbi gjunjët ose mbi kofshët (si në foton nr: 5), duke qenë në këtë pozicion thua dy herë: "رَبِّ اغْفِرْ لِي"

"Rab-bi gfirli"

"O Zot, më fal!".



(8) Bie në sexhde për të dytën herë (si në foton nr: 4.1-4.4) duke thënë: "اَللهُ أَكْبَرُ"

"Allahu Ekber"

Më pas thua tre herë:

"سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى" **"Subhane Rab-bijel Ala"**


(9) Ngre kokën nga sexhdja dhe ngrihesh në këmbë për në rekatin e dytë duke u mbështetur tek gjunjët nëse ke mundësi (e kundërta e fotos nr: 3) e thua:

"اَللهُ أَكْبَرُ" **"Allahu Ekber"**

(10) Lexon suren Fatiha dhe ç'të mundesh prej Kur'anit duke e vendosur dorën e

djathtë mbi të majtën, pastaj vepron si në rekatin e parë.

(11) Nëse namazi është me dy rekate, si namazi i sabahut, i xhumasë dhe i bajramit, pasi të ngrihesh nga sexhdja e dytë ulesh (si në foton nr: 6),



pastaj thua teshehudin:

"التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ، وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ، اَلسَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللهِ وَبَرَكَاتُهُ، اَلسَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللهِ الصَّالِحِينَ. أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللهُ، وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ"

"Et-tehij-jatu lil-lahi ues-saleuatu uet-taj-jibatu es-selamu alejke ejuhen-nebiju ue rahmetullahi ue berekatuhu, es-selamu alejna ue ala ibadil-lahi salihin, eshhedu el-la ilahe ila-llah ue eshhedu en-ne Muhameden abduhu ue resuluhu"

"Lavdërimet më të mira janë vetëm për Allahun. Paqja, mëshira dhe lavdërimet e Allahut qofshin gjithmonë mbi ty, o Pejgamber! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë! Dëshmoj se askush dhe asgjë tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut. Dëshmoj gjithashtu se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij".

Pastaj thua (salevatet):

"اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى